



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 6 dhe nenin 64.2 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 11.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Tekstit për Publikim në Ueb Faqen e KQZ-së për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votueseve Jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Miratohet Teksti për publikim në ueb faqen e KQZ-së, për periudhën e aplikimit për regjistrim të votueseve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.
- II. Teksti për publikim në ueb faqe të KQZ-së si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 11.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



NË GJUHËN SHQIPE:

<https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

Nëse jeni qytetar i Kosovës i regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës apo nëse jeni regjistruar suksesshëm për votim përmes postës në zgjedhjet e fundit

Hapi 1 Shkarko dhe plotëso formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës

Formulari i aplikimit për votim jashtë Kosovës – Formulari I



Hapi 2 Bashkangjit dokumentet mbështetëse

Për t'u regjistruar me sukses, ju duhet të bashkangjitni një kopje të dokumentit valid të identifikimit.

Nëse jeni shtetas i Republikës së Kosovës, ju duhet ta shkarkoni, plotësoni dhe nënshkruani Formularin I. Së bashku me formularin, ju duhet që ta dërgoni edhe një kopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit të Republikës së Kosovës (letërnjoftim të vlefshëm, pasaportë të vlefshme ose patent shofer të vlefshëm). Në rast se, dokumenti i Republikës së Kosovës është me afat të skaduar, atëherë ju duhet ta dërgoni një kopje të dokumentit të vlefshme të identifikimit të shtetit ku jetoni.

Nëse ju, keni fituar të drejtën për të votuar në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 6 tetor 2019 dhe në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut të datës 29 nëntor 2020, ju nuk do të keni nevojë që ta dëshmoni njërën nga kriteret e zotësisë juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 14.02.2021. Në këtë rast, mjafton që ju ta dëshmoni kriterin e identitetit, duke dërguar njërën nga kopjet e dokumentit të vlefshëm të identifikimit të shtetit ku jetoni, si: kopje të dokumentit të identifikimit, ose kopje të pasaportës ose kopje të patent shoferit.

Nëse nuk jeni shtetas i Kosovës i regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës

Hapi 1 Shkarko dhe plotëso formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës

Formulari i aplikimit për votim jashtë Kosovës – *Formulari II*



Hapi 2 Bashkangjit dokumentet mbështetëse

Për t'u regjistruar me sukses, ju duhet të bashkangjiti një kopje të dokumentit valid të identifikimit dhe dokumentet të cilat e vërtetojnë se ju keni të drejtë për të qenë shtetas i Kosovës.

Nëse nuk jeni shtetas i Republikës së Kosovës, i regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, por keni të drejtë për të qenë shtetas sipas Ligjit për Shtetësi, në këtë rast, ju duhet ta shkarkoni, plotësoni dhe nënshkruani Formularin II, të cilin ia bashkëngjiti një kopje të dokumentit identifikues të shtetit ku jetoni, qoftë kopje të letërnjoftimit, ose kopje të pasaportës, ose kopje të patent shoferit. Me njërin nga këto dokumente, ju e dëshmoni vetëm identitetin tuaj, por jo edhe kriterin për tu përfshirë si votues, në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Aplikuesi i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës për ta dëshmuar njërin nga kriteret e zotësisë juridike, të cilat janë të mjaftueshme për tu përfshirë si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës, atëherë ju duhet ta dërgojë njërin nga kopjen e dokumenteve të më poshtme:

NËSE KENI LINDUR NË KOSOVË: Ju mund ta dërgoni njërin nga këto dokumente:

- Kopjen e dokumentit identifikues, kopjen e pasaportës ose kopjen e patent shoferit të lëshuar nga administrata e UNMIK-ut, ose,
- Kopjen e certifikatës së lindjes e lëshuar nga administrata e UNMIK-ut,
- Kopjen e certifikatës së martesës e lëshuar nga administrata e UNMIK-ut, ku dëshmohet se keni lindur në Kosovë,

- Kopjen e certifikatës së lindjes e lëshuar nga Republika e Kosovës,
- Kopjen e certifikatës së martesës e lëshuar nga Republika e Kosovës, ku dëshmohet se keni lindur në Kosovë,
- Kopjen e një dokumenti të lëshuar nga administrata e ish Jugosllavisë, si letërnjoftim, pasaportë, patent shofer, certifikatë e lindjes, etj., ku këto dokumente duhet të përmbajnë si datë të lëshimit të dokumentit, më së largu me 10 qershor 1999, dhe në të cilat dokumente vendi i lindjes është në Kosovë.

NËSE KENI NJËRIN PRIND TË LINDUR NË KOSOVË: Ju mund ta dërgoni njërin nga këto dokumente:

- Kopjen e dokumentit identifikues, ose certifikatën e lindjes, e lëshuar nga Republika e Kosovës, ose administrata e UNMIK-ut, ose administrata e ish – Jugosllavisë të prindit tuaj, ku përmes njërës nga këto dokumente dëshmohet si prindi juaj ka lindur në Kosovë, dhe në këtë rast ju duhet ta dërgoni edhe një kopje të dokumentit, si certifikatë e lindjes së shtetit ku jetoni, ku në këtë dokument emri i prindit tuaj përputhet me dokumentet e kërkuara të cilat janë lëshuar nga Republika e Kosovës, administrata e UNMIK-ut, ose administrata e ish – Jugosllavisë.